

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Andi ÇELIKU	- Kryesues
Arjana FULLANI	- Anëtar
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Artan BROCI	- Anëtar
Tom NDRECA	- Anëtar

në datën 25.04.2017, në seancë gjyqësore me prani të palëve, mori në shqyrtim çështjen administrative me Nr. 04132/2014 që u përket palëve:

PADITËS: **Hekuran Braho**

PALË E PADITUR: **Ministria e Mbrojtjes**

OBJEKTI: *Shfuqizimin e Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 804 “Për dalje në rezervë të oficerëve aktive”, pika I (1) që ka të bëjë me paditësin Hekuran Braho.
Rikthimin në detyrën që mbaja para daljes së këtij urdhri, si Shef i ORL Okulistikë në SUQU Tiranë.
Detyrimin për të paguar diferencën e pagës për periudhën e qëndrimit në rezervë deri në kthimin në vendin e mëparshëm të punës si Kolonel e Shef i ORL Okulistikë në SUQU Tiranë.
Pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ – Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 804, datë 17.05.2012 “Për dalje në rezervë të oficerëve aktive”, pika I (1) që ka të bëjë me paditësin Hekuran Braho, deri në përfundim të gjykimit.*

BAZA LIGJORE: *Neni 32, 324-332 K.Pr.Civil; nenet 115, 116, 118, 137 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës Administrative”; Ligji Statusi i Ushtarakut, Ligji nr. 9171, datë 22.01.2004 “Për Gradat dhe Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH”, i ndryshuar.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 291, datë 22.01.2013, ka vendosur:

- Pranimin e padisë të paditësit Hekuran Braho si të bazuar në prova dhe në ligj.
- Anullimin e pjesës së aktit administrativ: Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 804, datë 23.05.2012, Pika I (1) për urdhërimin e nxjerrjes në rezervë të paditësit Hekuran Braho.
- Rikthimin e paditësit Hekuran Braho me gradë “Kolonel” në detyrën e mëparshme, Shef i Shërbimit të ORL Okulistikë dhe Maxilo-Facial në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar (SUQU) Tiranë ose në një detyrë tjetër të njëjtë.
- Detyrimin e palës së paditur Ministria e Mbrojtjes t’i paguajë paditësit diferencën e pagës për periudhën e qëndrimit në rezervë deri në kthimin e tij në detyrë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1265, datë 07.04.2014, ka vendosur:

-Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes nr. 3393/990 Regjistri Themeltar, datë 08.05.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2550, datë 26.06.2014, ka vendosur:

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 291, datë 22.01.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

V E N D O S I

**Nr. 31001-04132-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-543 i Vendimit (331)**